

20101182290

L I G J
PËR RREGULLIMIN E DETYRIMEVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NDAJ
FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR NË BAZË TË SHFRYTËZIMIT TË
MJETEVE NGA ALOKACIONI KUMULATIV NETO I PËRGJITHSHËM DHE
SPECIAL I TË DREJTAVE SPECIALE PËR TËRHEQJE TË LEJUARA ME
REZOLUTËN E BORDIT TË GUVERNATORËVE TË FONDIT MONETAR
NDËRKOMBËTAR NUMËR 64-3 DHE NUMËR 52-4

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen obligimet e Republikës së Maqedonisë ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar në bazë të shfrytëzimit të mjeteve nga alokacioni kumulativ neto i përgjithshëm i të drejtave speciale të tërheqjes në shumë prej 51 076 245 DST të miratuara nga Bordi i Guvernatorëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar me Rezolutën numër 64-3 nga 7 gushti 2009 dhe alokacioni kumulativ neto special i të drejtave speciale të tërheqjes në shumë prej 6 161 937 DST të miratuara nga Bordi i Guvernatorëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar me Rezolutën për ndryshimin e katërt të Statutit të Fondit numër 52-4 nga 23 shtatori 2007 e cila hyn në fuqi më 10 gusht 2009.

Neni 2

Autorizohet Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë në cilësinë e agjentit fiskal të Republikës së Maqedonisë dhe depozitarit të mjeteve monetare të Fondit Monetar Ndërkombëtar që t'i pranojë dhe t'i transferojë mjetet nga neni 1 i këtij ligji në llogari të veçantë të Ministrisë së Financave, e cila për këtë qëllim do të hapet në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë.

Neni 3

Mjetet nga neni 1 i këtij ligji do të shfrytëzohen për financimin e shpenzimeve buxhetore dhe borxhit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 4

Shfrytëzimi i mjeteve nga neni 1 i këtij ligji paraqet detyrim financiar të Republikës së Maqedonisë ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Mjetet nga neni 1 i këtij ligji do të kthehen në mënyrën dhe në afatin e paraparë në Statutin e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Kthimi i mjeteve nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimi i detyrimeve në bazë të kamatës dhe shpenzimeve tjera do të kryhet me mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, nëpërmjet Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë.

Neni 5

Ministria e Financave dhe Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë do të lidhin Marrëveshje për rregullimin e shfrytëzimit dhe kthimit të mjeteve nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".